



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE

08/07/2023

“QEVERISJA E SHOQËRIVE TREGTARE DHE ZBATIMI NË PRAKTIKË I KËRKESAVE TË ETIKËS PROFESIONALE DHE TË BIZNESIT”

ALTERNATIVA (13 x 1 pikë)

1. Një profesionist kontabël mund të përballet me një situatë në të cilën pajtueshmëria me një parim themelor bie në papajtueshmërinë me një ose më shumë parime të tjera themelore. Në një situatë të tillë, profesionisti kontabël mund të konsiderojë këshillimin, mbi një bazë anonime nëse është e nevojshme, me:
 - a) Të tjerë brenda firmës ose organizatës punëdhënëse
 - b) Personat e ngarkuar me qeverisjen
 - c) Një organizëm profesional
 - d) Një organ rregullator
 - e) Këshilltarin ligjor
 - f) Te gjitha alternativat e mesiperme
 - g) a,c,d
 - h) a,b,e

Përgjigja e saktë është alternativa F

2. Sipas Kodit Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël, kërcënimet për pajtueshmërinë me parimet themelore, cilës prej kategorive më poshtë i përkasin?
 - a) Kërcënimi i familjaritetit
 - b) Kërcënimi i favorizimit (përkrahjes)
 - c) Kërcënimi i profesionalizmit
 - d) Kërcënimi i frikësimit
 - e) Kërcënimi i pavarsisë
 - f) a, b, c
 - g) a, b, d
 - h) a, b, e

Përgjigja e saktë është alternativa G

3. Cila nga alternativat e mëposhtme mund të konsiderohet se mund të krijojnë një kërcënim të familjaritetit:

- a) Një anëtar i një grupi të angazhimit ka një marrëdhënie familjare të drejtëpërdrejtë ose të afërt me një drejtor apo nëpunës të klientit.
- b) Një anëtar i një grupi të angazhimit ka një marrëdhënie familjare të drejtëpërdrejtë ose të afërt me një punonjës të një klienti, i cili është në një pozicion ku ushtron influencë direkte dhe të rëndësishme mbi çështjen në fjalë të angazhimit.
- c) Një ish partner i firmës ka qënë drejtor, nëpunës, apo një i punësuar i klientit në një pozicion ku ka ushtruar influencë direkte dhe të rëndësishme mbi çështjen në fjalë të angazhimit.
- d) Lidhja e një drejtuesi kryesor të firmës së auditimit për një kohë të gjatë me klientin që i jepet shërbimi i sigurisë.
- e) A dhe B,
- f) A dhe C
- g) A, B dhe D
- h) A, B, C dhe D

Përgjigja e saktë është alternativa H

4. Cila nga rrethanat e mëposhtme mund të krijojnë kërcënimin e favorizimit (përkrahjes) për një auditues:
- a) Ekzistenca e një interesi financiar tek një klient apo edhe zotërimi së bashku me një klient i një interesi financiar të përbashkët.
 - b) Varësia e tepruar nga shuma e honorareve të pagesave që merren nga një klient i vetëm.
 - c) Ekzistenca e një marrëdhënie të ngushtë biznesi me një klient.
 - d) Një anëtar i një grupi të angazhimit ka një marrëdhënie familjare të drejtëpërdrejtë ose të afërt me një drejtor apo nëpunës të klientit.
 - e) Një ish partner i firmës ka qënë drejtor, nëpunës, apo një i punësuar i klientit në një pozicion ku ka ushtruar influencë direkte dhe të rëndësishme mbi çështjen në fjalë të angazhimit.
 - f) Lidhja e një drejtuesi kryesor të firmës së auditimit për një kohë të gjatë me klientin që i jepet shërbimi i sigurisë.
 - g) Përfaqësimi nga eksperti kontabël në rolin e avokatit, në zgjidhjen e çështjeve gjyqësore, ose të mosmarrëveshjeve me palët e treta, në emër të një klienti në të cilin ai kryen një angazhim të dhënies së sigurisë.
 - h) Raportimi lidhur me mënyrën e funksionimit të sistemeve financiare të klientit nga vetë audituesi që ka marrë pjesë në hartimin dhe zbatimin e tyre.

Përgjigja e saktë është alternativa G

5. Kontrolli i pavarësisë për një auditues duhet parë:
- a. Në nivel klienti;
 - b. Në nivelin individual si specialist i punësuar pranë një firme auditimi;
 - c. Në nivelin e firmës në tërësi, por edhe atë individual si profesionist
 - d. Vetëm në nivel firme, pasi është firma që lidh kontratën me klientin.
 - e. Të gjitha më sipër
 - f. a dhe b
 - g. a dhe c
 - h. Anjëra

Përgjigja e saktë është alternativa C

6. Nga të mëposhtmet është gjykim normativ:

- a) Në një komunikim me vartësin tuaj, pasi shikoni pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të 6 mujorit, shpreheni se shifrat e pasqyrës nuk janë të sakta;
- b) Në diskutimet me një koleg, shpreheni se zyra e eprorit të tyre është e pajisur me kompjutera, tavolina dhe karrige;
- c) Në diskutimet me një kolegë, shpreheni se skulptura (e vendosur në sheshin kryesor të qytetit) që po shihni është krijuar nga një skulptor italian;
- d) Gjatë diskutimit mbi mënyrën e vendosjes së çmimeve në industrinë 'Z', shpreheni se konsumatorët mendojnë se fiksimi i çmimeve është i padrejtë;
- e) B & C
- f) Në një komunikim me vartësin tuaj, pasi shikoni pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të 6 mujorit, shpreheni se shifrat e pasqyrës nuk rakordojnë me shifrat që zotëron audituesi i shoqërisë;
- g) Të gjitha;
- h) Asnjëra.

Përgjigja e saktë është alternativa A

7. Janë veçanërisht përcaktuese parashikimet që pritet të arrihen, si dhe nivelet e njohurive që shërbejnë për të vlerësuar e gjykuar, tek pikëpamja:

- a) kulturore
- b) situacionale
- c) politike
- d) universale
- e) e dobishmërisë/utilitare
- f) dialoguese
- g) religjioze
- h) të gjitha

Përgjigja e saktë është alternativa B

8. Bazohet në parimin ku pretendohet se puna apo përpjekjet duhet të shpërndahen në përputhje me aftësitë e njerëzve, ndërsa të ardhurat të shpërndahen në bazë të nevojave të tyre, drejtësia:

- a) kompensuese
- b) e bazuar tek kontributet
- c) egalitariste
- d) kapitaliste
- e) socialiste
- f) ndëshkuese
- g) të gjitha
- h) asnjëra

Përgjigja e saktë është alternativa E

9. Praktika diskriminuuese në ato organizata ku kualifikimet që iu kërkohen aplikantëve për tu punësuar nuk kanë të bëjnë fare ose fare pak me punën që do të kryhet, ka të bëjë me:
- a) praktikat e marrjes në punë
 - b) pushimet e padrejta nga puna
 - c) praktikat e promovimit
 - d) praktikat mbuluese
 - e) kushtet e punësimit
 - f) A dhe C
 - g) B dhe E
 - h) të gjitha

Përgjigja e saktë është alternativa D

10. Cila është përgjegjësia kryesore e bordit të drejtorëve?

- a) Maksimizimi i pasurisë së aksionarëve
- b) Sigurimi i kënaqësisë së punonjësve
- c) Mbrojtja e interesave të klientëve
- d) Zbatimi i përgjegjësisë sociale të korporatës
- e) Përfaqësimi i interesave të menaxhmentit
- f) Ruajtja e marrëdhënieve me qeverinë
- g) Mbikëqyrja e menaxhimit të kompanisë
- h) Sigurimi i pajtueshmërisë së furnizuesit

Përgjigja e saktë është alternativa G

11. Cfarë Nuk është qeverisja e korporatës?

- a) Marrëdhëniet ndërmjet aksionarëve dhe këshilltarëve të tregut të aksioneve
- b) Marrëdhëniet ndërmjet aksionarëve dhe Bordit të Drejtorëve
- c) Marrëdhëniet ndërmjet aksionarëve dhe Drejtorit të Përgjithshëm
- d) Marrëdhëniet ndërmjet aksionarëve, Bordit të Drejtorëve dhe organeve drejtuese
- e) Marrëdhëniet ndërmjet Bordit të Drejtorëve dhe Drejtorit të Përgjithshëm
- f) Marrëdhëniet ndërmjet pozicioneve drejtuese të larta
- g) Të gjitha të mësipërmet
- h) Asnje nga te mësipërmet

Përgjigja e saktë është alternativa A

12. Koncepti që propozon se korporatat kanë përgjegjësi ndaj shoqërisë që shtrihen përtej realizimit të një fitimi njihet si

- a) përgjegjësi fleksibël
- b) përgjegjësi sociale
- c) fleksibiliteti social
- d) përgjegjësi menaxheriale
- e) maksimizim fitimi

- f) e drejtat e palëve të interesuara (stakeholder)
- g) transparenca

Përgjigja e saktë është alternativa B

13. Kush i emëron audituesit e jashtëm në një kompani?

- a) Aksionarët
- b) Bordi i Drejtoreve
- c) Zyrtari më i lartë financiar
- d) CEO (Shef Ekzekutiv)
- e) Klientët
- f) Rregullatorët e qeverisë
- g) Punonjësit
- h) Furnizuesit

Përgjigja e saktë është alternativa B

PYETJE ME SHTJELLIM (5 pikë secila pyetje)

1. Sipas Standardet Ndërkombëtare të Etikës, një profesionist kontabël për të përgatitur ose paraqitur informacionin, mund të ushtrojë liriveprimin në bërjen e gjykimeve profesionale. Shpjegoni çfarë kuptohet me liriveprimin, si edhe jepni shembuj të rrethanave/ mënyrave në të cilat liriveprimi mund të keqpërdoret për të arritur rezultate të papërshtatshme

Përgjigje:

Gjatë kryerjes së aktiviteteve profesionale, veçanërisht të atyre *që nuk kërkojnë pajtueshmërinë me një kuadër përkatës të raportimit*, profesionisti kontabël do të ushtrojë gjykimin profesional për të identifikuar dhe marrë parasysh:

- (a) Qëllimin për të cilin do të përdoret informacioni;
- (b) Kontekstin brenda të cilit është dhënë informacioni; dhe
- (c) Publikun të cilit ai i drejtohet.

Për shembull, kur përgatiten ose paraqiten raporte paraprake, buxhete ose parashikime, përfshirja e çmuarjeve përkatëse, përafrimeve dhe supozimeve përkatëse, kur është e përshtatshme, do t'ju jepte mundësi atyre që të mund të mbështeten në këto informacione, për të formuar gjykimet e tyre. Profesionisti kontabël mund të konsiderojë gjithashtu, sqarimin e publikut të synuar, kontekstin dhe qëllimin e informacionit që do të paraqitet.

Pra përgatitja ose paraqitja e informacionit mund të kërkojë ushtrimin e liriveprimin në bërjen e gjykimeve profesionale. Profesionisti kontabël nuk do të ushtrojë këtë liriveprimi në funksion të çorientimit të të tjerëve, ose të influencimit në mënyrë të papërshtatshme të rezultateve kontraktuale ose rregullatore.

Shembuj të mënyrave në të cilat liriveprimi mund të keqpërdoret për të arritur rezultate të papërshtatshme, përfshijnë:

- Përcaktimin e çmuarjeve, për shembull, përcaktimi i çmuarjeve të vlerës së drejtë në mënyrë që të keq paraqitet fitimi ose humbja.
- Përzgjedhjen ose ndryshimin e një politike ose metode kontabël ndërmjet dy ose më shumë alternativave të lejuara sipas kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar, për shembull, zgjedhja e një politike për trajtimin kontabël të kontratave afatgjata me qëllim që të keqparaqitet fitimi ose humbja.
- Përcaktimi i afateve të transaksioneve, për shembull, koha e shitjes së një aktivi afër fundit të vitit fiskal në mënyrë që të çorientojë.
- Përcaktimi i strukturimit të transaksioneve, për shembull, strukturimi i transaksioneve të financimit në mënyrë që të mos paraqiten siç duhet aktivet dhe detyrimet ose klasifikimi i flukseve monetare.
- Përzgjedhjen e informacioneve shpjeguese, për shembull, lënia jashtë ose fshehja e informacionit që lidhet me rrezikun financiar ose operacional, në mënyrë që të çorientojë.

2. Konfidencialiteti i shërben interesit publik, pasi ai lehtëson rrjedhjen e lirë të informacionit nga klienti i profesionistit kontabël ose organizata punëdhënëse tek profesionisti kontabël duke ditur që informacioni nuk do të paraqitet tek një palë e tretë. Megjithatë ka rrethana, kur profesionistët kontabël kërkohet apo mund të kërkohet të japin informacione konfidenciale ose kur dhënia e këtyre informacioneve mund të jetë e përshtatshme. Cilat janë këto rrethana?

Përgjigje:

Rrethanat, kur profesionistët kontabël kërkohet apo mund të kërkohet të japin informacione konfidenciale ose kur dhënia e këtyre informacioneve mund të jetë e përshtatshme janë si më poshtë:

(1) Dhënia e informacioneve kërkohet nga ligji, për shembull:

- (i) Prodhimi i dokumenteve ose dhëniet e tjera të evidencës, gjatë procedurave ligjore, apo
- (ii) Informimi i autoriteteve përkatëse publike, për informacionet që zbulojnë shkeljet e ligjit;

(2) Dhënia e informacioneve lejohet me ligj dhe autorizohet nga klienti ose organizata punëdhënëse;

(3) Ekziston një detyrim ose një e drejtë profesionale për dhënien e informacioneve, kur nuk ndalohet nga ligji:

- (i) Për të vepruar në pajtim me procedurat e kontrollit të cilësisë të një organizmi profesional;
- (ii) Për t'iu përgjigjur një kërkesë ose një investigimi të bërë nga një organizëm profesional ose rregullator;
- (iii) Për të mbrojtur interesat profesionale të një profesionisti kontabël gjatë proceseve gjyqësore;
- (iv) Për të respektuar standardet teknike dhe profesionale, përfshirë kërkesat etike

3. Shpjegoni cilat janë kërkesat e Kodit të Etikës të IEKA në rastet e dhënies së opinionëve dytësore nga një auditues.

Përgjigje:

Opinionet Dytësore

Situatat, në të cilat një auditues kërkohet të japë një opinion dytësor lidhur me zbatimin e standardeve të kontabilitetit, auditimit, raportimit ose të standardeve apo parimeve të tjera, sipas rrethanave specifike apo për transaksionet e kryera nga ose në emër të një shoqërie a

entiteti që nuk është një klient ekzistues, mund të çojnë në kërcënime të respektimit të parimeve themelore.

Për shembull, mund të ketë një kërcënim ndaj kompetencës profesionale dhe kujdesit të duhur në rrethanat kur opinionin dytësor nuk është bazuar në të njëjtën seri faktesh që kanë qënë qënë disponibël për audituesin ekzistues, ose kur ky opinion është bazuar në një evidencë që është e pamjaftueshme. Rëndësia e kërcënimit do të varet nga rrethanat në të cilat bëhet kërkesa për dhënien e opinioneve dytësore dhe nga faktet e supozimet e tjera të mundëshme, që lidhen me shprehjen e një gjykimi profesional.

Kur një auditues kërkohet të japë një opinion të tillë, ai duhet të vlerësojë rëndësinë e kërcënimeve dhe, në qoftë se ato nuk janë krejt të parëndësishme, ai duhet të mbajë parasysh e të zbatojë ato masa mbrojtëse të nevojshme, që i eliminojnë apo i zvogëlojnë kërcënimet në një nivel të pranueshëm.

Në këto masa mund të përfshihet kërkimi i lejes prej klientit për të kontaktuar audituesin ekzistues, përshkrimi i kufizimeve që shoqërojnë opinionin për komunikimet me klientin dhe dhënia e një kopje të opinionit të audituesit ekzistues.

Në qoftë se entiteti që kërkon opinionin nuk lejon komunikimin me audituesin, një auditues duhet të vlerësojë, në varësi të rrethanave, në se është e përshtatëshme që ai të japë ose jo opinionin që kërkohet.

4. “Kujdesi i Duhur”. Cilat janë disa nga përgjegjësitë dhe kërkesat kryesore për një auditues me qëllim që përmbushja dhe respektimi i Kompetencës Profesionale dhe Kujdesit të Duhur”?

Përgjigje:

Një profesionist kontabël do të veprojë në pajtueshmëri me parimin e kompetencës profesionale dhe të kujdesit të duhur, i cili kërkon që një profesionist kontabël: (secila nga 0.5 pike)

(i) Të arrijë dhe të mbajë njohuri dhe aftësi profesionale në nivelin e kërkuar, për të garantuar që një klient ose organizata punëdhënëse marrin shërbime profesionale kompetente, të cilat bazohen në standardet aktuale teknike e profesionale dhe legjisllacionin përkatës, dhe

(ii) Të veprojë me kujdes dhe në pajtim me standardet e zbatueshme profesionale dhe teknike.

Mbajtja e kompetencës profesionale kërkon një ndërgjegjësim të vazhdueshëm dhe njohjen e standardeve përkatëse teknike e profesionale dhe zhvillimeve të biznesit. Zhvillimi i vijueshëm profesional i jep mundësi profesionistit kontabël të zhvillojë dhe të mbajë aftësitë profesionale për të ofruar shërbime me kompetencë dhe brenda mjedisit profesional.

Kujdesi përfshin përgjegjësinë për të vepruar në pajtim me kërkesat e një detyre të caktuar, në mënyrë të kujdesshme e të hollësishme dhe në kohën e duhur.

Për të qënë në pajtim me parimin e kompetencës profesionale dhe kujdesin e duhur, një profesionist kontabël do të ndërmarrë ato hapa që japin garanci, se personat të cilët punojnë

nën autoritetin e tij, në një kapacitet të caktuar profesional, kanë kualifikimin dhe mbikëqyrjen e duhur.

Kur është e nevojshme, një profesionist kontabël do të bëjë që klientët, punëdhënësit apo edhe përdorues të tjerë të shërbimeve ose aktiviteteve profesionale, të jenë të vetëdijshëm për kufizimet e vetvetishme të shërbimeve ose aktiviteteve.

5. Tregoni se si ndikon etika e biznesit tek punonjësit e kompanisë, tek investitorët e saj, tek klientët e kompanisë dhe tek fitimet e saj.

Përgjigje:

Ndërtimi i një reputacioni etik midis punonjësve, klientëve dhe publikut në përgjithësi, e rrit vlerën e kompanisë. Midis përfitimeve që vijnë nga të qenurit më shumë etikë dhe më shumë përgjegjës social në biznes, janë rritja e efikasitetit në operacionet e përditshme, një zotim apo angazhim më i madh i punonjësve, rritja e besimit të investitorëve për të vënë kursimet në dispozicion të biznesit, rritja e besimit dhe e kënaqësisë së klientëve dhe një performancë financiare më e mirë. Reputacioni i një kompanie ka një efekt të madh në marrëdhëniet e saj me punonjësit, investitorët, klientët dhe shumë palë të tjera.

- *Etika kontribuon në rritjen e zotimit dhe angazhimit të punonjësve*, duke i bërë më të gatshëm të sakrifikojnë për plotësimin e synimeve dhe qëllimeve të organizatës. Perceptimi i punonjësve se firma e tyre ka një mjedis etik çon në rezultate të përmirësuara brenda organizatës. Ndërtimi i marrëdhënieve të besimit midis drejtimit të lartë dhe menaxherëve të niveleve të mesme e të ulëta dhe vartësve të tyre, kontribuon në efikasitet të lartë të vendimmarrjes. Kur punonjësit shohin se vlera të tilla si ndershmëria, respekti dhe besimi janë të pranishme në mjedisin e punës, ata ndiejnë më pak presion për të kompromentuar standardet etike, bëjnë më pak sjellje jo etike dhe janë më të kënaqur me organizatën pas ndihen më të vlerësuar prej saj.
- *Etika kontribuon në besimin e investitorëve*. Investitorët në ditët e sotme po e rrisin interesin e tyre ndaj etikës së biznesit, përgjegjësisë sociale dhe reputacionit të kompanive me të cilat ata investojnë paratë. Ata e pranojnë se një klimë etike përbën një bazë për produktivitet, efikasitet dhe fitime. Investitorët e dinë se publiciteti negativ, paditë gjyqësore ose gjokat mund të ndikojnë në uljen e çmimit të aksioneve, mund të zvogëlojnë besimin e klientëve dhe mund të kërcënojnë vazhdimësinë afatgjatë të kompanive. Për të qenë të suksesshme, marrëdhëniet me investitorët duhet të bazohen në zotim dhe angazhim.
- *Etika kontribuon në kënaqjen e klientit*. Kënaqja e klientëve konsiderohet si një nga faktorët më të rëndësishëm për një strategji biznesi të suksesshme, dhe sugjerohet zhvillimi i marrëdhënieve afatgjata me klientët, dhe instalimi i një klime respekti bashkëpunimi midis klientëve dhe biznesit. Kur rritet besimi i klientëve, firma kupton më mirë mënyrën se si duhet t'i shërbejë klientëve, kështu që marrëdhënia mund të zgjasë për shumë kohë. Bizneset e suksesshme i japin rëndësi marrjes së feedbackut, vërejtjeve dhe sugjerimeve prej konsumatorëve, dhe në këtë mënyrë konsumatorët bëhen pjesë e zgjidhjes së

problemeve. Kur një organizatë ka një mjedis të shëndoshë etik, ajo zakonisht fokusohet në vlerat bazë duke vendosur në plan të parë interesat e konsumatorëve. Sjellja etike ndaj konsumatorëve ndërton një pozitë të fortë konkurruese dhe ka treguar se ndikon pozitivisht në performancën e biznesit, në inovacionin teknologjik dhe në përmirësimin e produkteve.

- *Etika kontribuon në rritjen e fitimeve.* Shumë studime tregojnë për ekzistencën e një marrëdhënie pozitive midis përgjegjësisë sociale të korporatës dhe performancës së biznesit. Ato kompani që perceptohen nga punonjësit për një shkallë të lartë etike, kanë një rritje në vlerën e aksioneve të tyre dhe pra në maksimizimin e pasurisë së aksionerëve. Interesimi i korporatave për sjelljen etike po bëhet pjesë e planifikimit strategjik që ka si qëllim rritjen e përfitueshmërisë.

6. Sipas mendimit tuaj, cilat janë karakteristikat apo cilësitë kryesore që e bëjnë një bord të drejtorëve efektiv në mbikëqyrjen e menaxhimit të kompanisë dhe sigurimin e qeverisjes së mirë të korporatës?

Përgjigje:

Një bord drejtorësh efektiv zotëron disa karakteristika dhe cilësi kryesore që kontribuojnë në qeverisjen e mirë të korporatës. Ndër të tjera këto përfshijnë:

a) Pavarësia: Pavarësia siguron që anëtarët e bordit mund të marrin vendime të paanshme pa u ndikuar nga interesa personale ose të jashtme. Drejtorët e pavarur sjellin objektivitet dhe një perspektivë të re në diskutimet dhe vendimmarrjen e bordit.

b) Kompetenca dhe ekspertiza: Anëtarët e bordit duhet të zotërojnë njohuritë, aftësitë dhe ekspertizën e nevojshme në lidhje me industrinë, operacionet dhe objektivat strategjike të kompanisë. Kjo siguron që ata të mund të vlerësojnë në mënyrë efektive vendimet e menaxhimit dhe të ofrojnë njohuri dhe udhëzime të vlefshme.

c) Diversiteti: Një bord i larmishëm sjell një sërë këndvështrimesh, përvojash dhe prejardhjesh, të cilat mund të çojnë në një vendimmarrje më të fuqishme dhe një kuptim më të mirë të interesave të palëve të interesuara. Diversiteti duhet të përfshijë faktorë të tillë si gjinia, përkatësia etnike, mosha dhe prejardhja profesionale.

d) Përgjegjësia: Anëtarët e bordit duhet të jenë përgjegjës ndaj aksionarëve dhe palëve të tjera të interesuara, duke u siguruar që ata veprojnë në interesin më të mirë të kompanisë. Ata duhet të ushtrojnë mbikëqyrje mbi menaxhimin, të monitorojnë performancën dhe të marrin përgjegjësi për dështimet e qeverisjes.

e) Komunikimi efektiv: Komunikimi i hapur dhe transparent brenda bordit dhe me palët e interesuara është jetik. Anëtarët e bordit duhet të jenë në gjendje të shprehin pikëpamjet e tyre dhe të angazhohen në dialog konstruktiv për të arritur vendime të mirëinformuara.

f) Sjellja etike: Anëtarët e bordit duhet t'u përmbahen standardeve të larta etike dhe të promovojnë sjelljen etike në të gjithë organizatën. Kjo përfshin veprimin me integritet, shmangien e konflikteve të interesit dhe sigurimin e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

7. Me çfarë sfidash përballen kompanitë e listuara ne bursa në drejtim të qeverisjes së korporatave dhe si mund të balancojnë në mënyrë efektive interesat e palëve të ndryshme të interesuara, si aksionarët, punonjësit, klientët dhe komuniteti më i gjerë?

Përgjigje:

Kompanitë e listuara përballen me disa sfida në drejtim të qeverisjes. Një nga sfidat kryesore është konflikti i mundshëm i interesit ndërmjet palëve të ndryshme të interesit. Aksionarët, punonjësit, klientët dhe komuniteti më i gjerë shpesh kanë interesa dhe prioritetë të ndryshme. Aksionarët kërkojnë të maksimizojnë kthimet nga investimet e tyre, ndërsa punonjësit mund t'i japin përparësi pagave të drejta dhe kushteve të punës. Konsumatorët presin produkte ose shërbime me cilësi të lartë me çmime të arsyeshme dhe komuniteti i gjerë mund të vlerësojë qëndrueshmërinë mjedisore dhe përgjegjësinë sociale. Balancimi i këtyre interesave të ndryshme mund të jetë kompleks dhe sfidues për kompanitë.

Për të balancuar në mënyrë efektive interesat e palëve të ndryshme të interesuara, kompanitë e listuara mund të miratojnë disa strategji. Së pari, ata mund të krijojnë korniza të fuqishme të qeverisjes korporative që promovojnë transparencën, llogaridhënien dhe sjelljen etike. Kjo përfshin anëtarësimin e pavarur të bordit, struktura të qarta raportuese dhe zbulimin e rregullt të informacionit financiar dhe jofinanciar. Së dyti, kompanitë mund të përfshihen në proceset e dialogut dhe konsultimit me palët e interesuara për të kuptuar dhe trajtuar shqetësimet e tyre. Kjo mund të përfshijë kanale të rregullta komunikimi, të tilla si takimet e aksionarëve, forumet e punonjësve, mekanizmat e reagimit ndaj klientit dhe iniciativat e angazhimit të komunitetit. Për më tepër, kompanitë mund të adoptojnë praktika të qëndrueshme dhe të përgjegjshme biznesi që marrin parasysh interesat afatgjata të të gjitha palëve të interesuara. Kjo mund të përfshijë zbatimin e politikave miqësore me mjedisin, sigurimin e trajtimit të drejtë të punonjësve dhe mbështetjen e komuniteteve lokale nëpërmjet iniciativave të përgjegjësisë sociale të korporatës. Duke i dhënë përparësi komunikimit të hapur, vendimmarrjes së përgjegjshme dhe angazhimit të palëve të interesuara, kompanitë e listuara publikisht mund të përpiqen të arrijnë një ekuilibër midis interesave të palëve të ndryshme të interesit.

USHTRIME

Ushtrimi 1 (6 pike)

Esse Co është një kompani ndërkombëtare me bazë në Evropë e cila tregon kryesisht në Azi dhe Evropë. Në Kodin e saj të Etikës të botuar, Esse është zotuar se do të jetë një kompani që do të tregtojë në mënyrë të drejtë dhe të qëndrueshme. Esse ka ndjekur një strategji zgjerimi, e cila ka çuar në dy situatat e mëposhtme:

Situata 1

Në një prezantim të fundit për analistët e investimeve dhe gazetarët financiarë, CEO i Esse dha një parashikim shumë optimist për të ardhmen e kompanisë, duke sugjeruar se të ardhurat do të dyfishoheshin gjatë tre viteve të ardhshme dhe fitimet dhe dividendët do të rriteshin me 50%. Megjithatë, CEO e kishte përgatitur parashikimin e tij me nxitim dhe nuk e kishte konfirmuar atë nga askush tjetër brenda Esse. Ai nuk përmendi se qeveria në vendin që Esse operon, po shqyrtonte veprime ligjore kundër kompanisë për mospagesë të detyrimeve të importit dhe kishte bërë kërkesë për dëmshpërblim. Nëse është i suksesshëm, ky pretendim do të ndikonte materialisht në fitimin e Esse në vitin e ardhshëm (20X3).

Situata 2

Në lidhje me çështjen ligjore në Situatën 1, qeveria në vendin që Esse operon kishte marrë një urdhër gjykatë që të gjitha dokumentet në lidhje me tregtinë e eksportit të Esse duhet t'i vireshin në dispozicion avokatëve të qeverisë.

Megjithatë, shumë nga dokumentet e mbuluara nga urdhri i gjykatës ishin objekt i marrëveshjeve të konfidencialitetit midis Esse dhe sipërmarrësve të ndryshëm. Këto dokumente përfshinin detaje të patentave dhe procese me vlerë të lartë komerciale dhe nëse njohja e tyre do të bëhej publike, kjo do të shkatërronte disa nga avantazhet konkurruese të Esse.

Kërkohet:

Këshilloni, duke dhënë arsyet përkatëse, nëse secila prej situatave të mësipërme është në konflikt me parimet themelore të Kodit Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël.

Përgjigje:

Situata 1

Integriteti. Kjo situatë mund të jetë në kundërshtim/konflikt me parimin themelor të integritetit. Kodi Ndërkombëtar i Etikës për Profesionistët Kontabël thekson se parimi i integritetit kërkon që kontabilistët të jenë 'të ndershëm, të drejtpërdrejtë dhe të vërtetë' në të gjitha marrëdhëniet e biznesit.

Parimi i integritetit gjithashtu nënkupton që profesionistët e biznesit nuk duhet të shoqërohen me asnjë informacion që ata besojnë se përmban një deklaratë materialisht të rreme ose mashtruese, ose që është keqduhëzuese nga pasaktësia.

Përmban një deklaratë materialisht të rreme ose keqduhëzuese. CEO ka paraqitur një parashikim shumë optimist për fitimet e Esse dhe kjo mund të jetë keqduhëzuese nëse pretendimi i qeverisë për dëmshpërblim kundër kompanisë është i suksesshëm.

Mospërfshirja e informacionit kur një veprim i tillë do të ishte keqduhëzues. Edhe pse kërkesa e qeverisë për dëshmipërblim do të 'ndikonte materialisht' në fitimin e Esse për 20X3 nëse do të ishte e suksesshme, CEO nuk e përmendi pretendimin në prezantimin e tij para analistëve dhe gazetarëve. Prandaj, mospërfshirja e këtij informacioni është keqduhëzuese, sepse e pengon audiencën të jetë e vetëdijshme se fitimi i Esse për 20X3 mund të jetë materialisht më i ulët se shifra e dhënë në parashikim.

Këshillë: Parashikimi dhe prezantimi i CEO-së demonstrojnë karakteristikat e komunikimit që bien ndesh me parimin e integritetit. Drejtori Ekzekutiv nuk ka qenë i sigurtë në marrëdhëniet e tij me analistët dhe gazetarët, prandaj situata 1 paraqet një konflikt me parimin e integritetit.

Situata 2

Konfidencialiteti. Parimi që mund të rrezikohet këtu është konfidencialiteti. Kodi Ndërkombëtar i Etikës për Profesionistët Kontabël kërkon që kontabilistët dhe firmat të përmbahen nga zbulimi, jashtë firmës së tyre, të informacionit konfidencial që është marrë si rezultat i marrëdhënieve të biznesit me atë firmë.

Shumë nga dokumentet që avokatët e qeverisë kanë kërkuar përmbajnë informacion konfidencial, i cili sugjeron se mund të ketë një konflikt me parimin e konfidencialitetit nëse ato dorëzohen.

Përrjashtim: Procedurat ligjore. Megjithatë, Kodi i Etikës bën përrjashtim nga parimi i konfidencialitetit në kontekstin e procedurave ligjore. Me fjalë të tjera, parimi i konfidencialitetit nuk shkelet nëse informacioni konfidencial zbulohet kur kërkohet gjatë procesit gjyqësor. Ky është rasti në situatën 2. Esse i është kërkuar të paraqesë dokumentet si rezultat i urdhrit të gjykatës të marrë nga qeveria.

Këshillë: Megjithëse dokumentet përmbajnë informacion konfidencial, Situata 2 nuk paraqet një konflikt me parimet e Kodit të Etikës Profesionale.

Ushtrimi 2 (6 pike)

ABC sh.p.k, ka përditësuar Kodin e saj të Etikës. Kompania kryen të gjithë biznesin e saj mbi parimet etike të këtij Kodi dhe pret që stafi të bëjë të njëjtën gjë. Sipas këtij Kodi, punonjësit shihen si komponenti më i rëndësishëm i kompanisë dhe pritët të punojnë mbi bazën e besimit, respektit, ndershmërisë, drejtësisë, mirësjelljes dhe barazisë. Kompania do të punësojë vetëm njerëz që ndjekin idealet e saj etike.

Mirëpo, para një muaji, një prej punonjësve më të disiplinuar të ABC sh.p.k, John Smith, u zbulua se kishte përdorur pozicionin e tij manaxherial për interesat e tij personale, qartësisht në kundërshti me Kodin e Etikës. Pra, edhe pse ABC sh.p.k përpiloi një Kod shumë të mirë etik bazuar në praktikën më të mirë, në zbatim John e shkeli atë duke e tejkaluar.

Kërkohet: Agumentoni në mënyrë të strukturuar sesi ABC sh.p.k mund të influenconte sjelljen e punonjësve të saj, e më konkretisht të John Smith, drejt përmbushjes së plotë të parimeve të Kodit të Etikës dhe çështjeve të lidhura me të.

Përgjigje:

ABC sh.p.k. mund të influenconte sjelljen e punonjësve të saj, e më konkretisht të John Smith, drejt përmbushjes së plotë të parimeve të Kodit të Etikës, si më poshtë:

1. Implementimin i Kodit të Etikës në mënyrë që të jetë i suksesshëm duhet që të marrë në konsideratë karakteristikat specifike të kompanisë duke u bazuar te historiku dhe rrethanat e tjera aktuale.
2. Kultura ka ndikim të rëndësishëm në implementimin me sukses të etikës në nivel makro dhe mikro. Për këtë arsye, nuk mund të ketë një Kod Etike që funksionon për çdo vend, pasi çdo vend ka karakteristikat e tij kulturore.
3. Kompania duhet të merrte masa që jo vetëm punonjësit e rinj, por edhe ata ekzistues do të përshtateshin dhe do ta zbatonin Kodin e Etikës. Për këtë arsye, duhet të ishte bërë e qartë nëpërmjet një programi të plotë dhe të shtrirë në kohë trajnimi.
4. Ndryshimi është gjithmonë i vështirë për t'u pranuar pasi njerëzit krijojnë rutinat e tyre dhe ndihen në një pozicion komfort me to. Për këtë arsye, lidhshipi i kompanisë duhet të ishte i qartë në vizionin e tij, mbi arsyet pse ky ndryshim po bëhet dhe cilat do të jenë efektet pozitive të këtij ndryshimi. Duhet të theksonte faktin që punonjësit nuk do të ndikoheshin negativisht dhe do të ishte në dobinë e të gjithëve.
5. Lidhshipi gjithashtu duhet të ushtronte një përfshirje më të madhe të punonjësve nga poshtë lart, për të kuptuar realisht nevojat dhe problemet e tyre, qasjet dhe vështirësitë që ky kod do i krijonte, pasi nëpërmjet përfshirjes ata bëhen pjesë e vendimarrjes dhe zbatimi i kodit do të ishte shumë më i lehtë. Gjithashtu, edhe pas vendimarrjes për Kodin e ri, ata duhet të përfshihen në dhënien e feedback në mënyrë që Kodi të përditësohet me praktikën më të mira dhe të përshtatshme.
6. Së fundi, pavarësisht sa efektiv është kodi në vetvete dhe pavarësisht sa me efektivitet ndikohen punonjësit në zbatimin e tij nëpërmjet pikave më sipër, gjithmonë do të ketë individ si John që me vetëdije dhe për interesa personale do të përpiqen ta tejklalojnë dhe të mos e zbatojnë, pasi lakmia dhe ego personale është gjithmonë e fortë he e pranishme.
Për këtë arsye, kompania duhet të ndërtojë një strukturë kontrolli të brendshme ose auditimi të brendshëm, ku ndër procedura të tjera të ketë edhe nivelin e zbatueshmërisë me kodin e etikës, rregulloret e tjera dhe ligjet, në mënyrë që individ të tillë si John të parandaloheshin të bënin veprime të tilla, ose edhe kur të bëheshin të identifikohen e korrigjohen në kohë për të minimizuar dëmin.

Shënim - përgjigje të ngjashme apo pika të tjera argumentuese mbi mënyrën sesi mund të influencoheshin punonjësit mund të jenë gjithashtu të sakta.

Ushtrimi 3 (6 pike)

